



KOMUNA E LIPJANIT

BULETINI MUJOR

TETOR 2020

KOMUNA E LIPJANIT TANI EDHE
ME SHTIGJE MODERNE TË ECJES



I pari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti së bashku me bashkëpunëtor dhe zëvendësministrja MAPL-së, Makbule Shkodra dhe qytetarë të tjerë ka bërë përurimin e shtigjeve të ecjes në Lipjan, ku është mabjtur edhe gara "Vrapimi i krushqeve", garë tradicionale.

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/>
0 800 14 000

Po vazhdon rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në fshatin Krojmir

Në kuadër të shumë projekteve kapitale që po realizohen në teren, ka vazhduar rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në fshatin Krojmir.



Asfaltohet rruga “Marie Shllaku” në Lipjan


Kryetari Ahmeti ka përciell punimet në asfaltimin e rrugës “Marie Shllaku” në Lipjan.



Kanë nisur punimet për ndërtimin e rrjetit të ndriqimit publik përgjat rrugës Lipjan-Magure



Përfundon rregullimi i Kroit të fshatit Kraishtë



Filluan punimet në asfaltimin e rrugës Llugë – Radevë

Kryetari Ahmeti ka theksuar se me realizimin e këtij projekti do të lidhet komuna e Lipjanit me komunën e Graçanicës dhe përveç që do të lehtësohet qarkullimi i qytetarëve do të shkurtohet rruga për banorët e këtij regjioni për disa kilometra për çasje më të lehtë në Fushë Kosovë dhe Prishtinë.



Kanë filluar punimet për ndërtimin dhe asfaltimin e rrugës Sllovi-Akllap





4500 FAMILJE ME SHPORTA TË REJA PËR MBETURINA

KOMUNA E LIPJANIT DHE KOMPANIA
"PASTRIMI" KANË PAJISUR ME
SHPORTA TË REJA 4500 FAMILJE NË
KOMUNEN E LIPJANIT.



4500 familje në Komunën e Lipjanit janë pajisur me shporta të mbeturinave. Do vazhdojmë në çdo fshat e në çdo lagje të pajisën me shporta çdo familje, dhe do të lirojmë nga pagesa familjet në asistencë sociale.

NGJARJE TË TJERA

- QKMF në Lipjan nga neser fillon shërbimin e ultrazerit të gjirit pa pagesë
- Kryetari Ahmeti, ka pritur Kryetarin e Bashkisë së Vlorës së Shqipërisë Dr. Dritan Leli
- Tetori – Muaji i mundësive të barabarta
- Kanë filluar punimet për ndërtimin dhe asfaltimin e rrugës Sllovi-Akllap
- Rruga e Shkupit dhe rruga e Lumit në Gadime të Ulët filluan të ndërtohen
- Kryetari Imri Ahmeti nënshkruan memorandum mirëkuptimi me Kosova -Women 4 Women (KW4W)
- Hapet panairi i prodhimeve bujqësore në Lipjan



Rruga e Shkupit dhe rruga e Lumit në Gadime të Ulët filluan të ndërtohen



Filluan punimet në rrugën transit nga lagjja e Konjuhut deri te rruga Lipjan-Janjevë




Kanë filluar punimet në rregullimin e shtratit të lumit në Dobrajë



Së shpejti do të përfundojnë punimet në ndërtimin e trotuarëve të përcjellur me ndriqim publik në fshatin Sllovi.

Komunës së Lipjanit ky projekt po i kushton rreth 70 mijë euro



Tetori Rozë, 1 muaji i ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit



Në kuadër të aktiviteteve “Tetori – Muaji i mundësive të barabarta profesionale për personat me aftësi të kufizuara”, në Komunën e Lipjanit ka filluar promovimi kësaj fushate e cila synon ngritjen e vetëdijes për bashkëpunim institucional dhe tek qytetarët e komunës sonë për mbështetje pa rezervë e të fuqishme personave me aftësi të kufizuara (PAK).



Kryetari Imri Ahmeti nënshkruan memorandum mirëkuptimi me Kosova -Women 4 Women (KW4W)



Kryetari Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti dhe Iliriana Gashi nga mes Kosova -Women 4 women (KW4W), sot kanë nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi që ka për synim krijimin e partneritetit mes Kosova -Women 4 Women dhe Komunës së Lipjanit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme që kanë synime të përbashkëta.

Marrëveshje për furnizim me pajisje të teknologjisë informative, me Ministrin Blerim Kuçi



Eshtë nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi në mes të Komunës së Lipjanit dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit për Financimin e Projektit Furnizim me Pajisje të teknologjisë informative për Shkollat e Mesme.

Kryetari Ahmeti, ka pritur Kryetarin e Bashkisë së Vlorës së Shqipërisë Dr. Dritan Leli



Kryetari Ahmeti pret në takim Ministrin Arban Abrashi dhe Kryeshefin e Hekurudhave të Kosovës Xhevat Ramosaj



Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, Ministri Infrastrukturës Arban Abrashi dhe Kryeshefin e Hekurudhave të Kosovës Xhevat Ramosaj, kanë diskutuar lidhur me zhvillimin e projektit të rregullimit të infrastrukturës së hekurudhave në këtë rast hekurudhës që kalon në qytetin e Lipjanit.

Projekt dokumenti “Hartat Zonale e Komunës së Lipjanit 2020-2028” drejt finalizimit



"Ky dokument është shumë i rëndësishëm dhe kontributi i secilit është i domosdoshëm rreth hartimit Hartat Zonale e Komunës së Lipjanit 2020-2028" ka thënë Kryetari Ahmeti.

Kryetari Imri Ahmeti, në orët e pasdites ka zhvilluar një takim virtual me Kolegjiumin e kryetarëve të Komunave të Kosovës dhe me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës, ku temë diskutimi ishte trajtimi i qeneve endacak. Kërkesa e Kryetarëve të komunave ishte AUV të merret më seriozisht me trajtimin e qeneve endacak.



U zhvilluan punimet e mbledhjes së 38-të të Kuvendit Komunal

Në Sallën e Kuvendit Komunal nën kryesimin e nënkryetarit të Komunës Fauz Xhemajli është mbledhja e rregullt Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), ku temë diskutimi ishte gjendja e sigurisë në Komunën e Lipjanit.



Drejtori për Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Lipjanit, Bekim Shabani ka pritur në takim përfaqësuesit nga UNDP Znj.Marta Gazideda dhe përfaqësuesit nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit njëherësh vizituan Janjevën. Zyra e EU-së në Kosovë së bashku me UNDP-në, Ministria e Kulturës dhe Komuna e Lipjanit pritët që në kuadër të Trashëgimisë Kulturore Zhvillimi Rural, programin "Ruajtja dhe Rigjenerimi i Qendrës Historike e Janjevës" ky projekt do të sillet rreth vlerës 3 milion euro.



Kryetari Imri Ahmeti sot ka pritur në takim ambasadoren e Kroacisë në Republikën e Kosovës, znj. Danijela Barišić.



Kryetari Imri Ahmeti pret në takim Komandantin i kampit Bondsteel, Erik Zimmerman



Është diskutuar gjendja e sigurisë në Komunën e Lipjanit.

Komandanti Zimmerman: Përgëzoi Kryetarin Imri Ahmeti për punën dhe ka vlerësuar lartë kontributin tij në shërbim të qytetarëve.

Ministria e Shëndetësisë dhuron 7 mijë maska për komunitetet në Lipjan



Komuna shpërndan motokultivarë për bujqit lipjanas



**KËTË VIT 148 FERMERË KANË
PËRFITUAR NGA NJË
MOTOKULTIVATOR!**



Kryetari Komunës së Lipjanit Imri Ahmeti: "Bujqësia është një sektor mjaftë i rëndësishëm dhe mbështetja është rritur dukshëm në vitet e fundit, gjë që ka dhënë rezultate me rritje të prodhimit, për të arritur synimin që të zëvendësohet importi dhe të shtohet sa më shumë konsumi i prodhimeve vendore".



Hapet panairi i prodhimeve bujqësore në Lipjan



Po vazhdojnë punimet në renovimin e QMF-ve në Janjevë dhe Sllovi dhe Babush



Kryetari Imri Ahmeti priti shumë përfaqësues të misioneve të ndryshme në Kosovë për të festuar 75 vjetorin OKB-së



KONKURS PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË LIPJANIT



KOMUNA E LIPJANIT

TË DASHUR STUDENT

APLIKONI PËR BURSA!

Komuna e Lipjanit ndanë 80 bursa nga 500 euro për studentët e vitit akademik 2020/21.




Ditët e fundit psikologët shkollorë të Komunës së Lipjanit kanë filluar mbajtjen e ligjëratave rreth ruajtjes së shëndetit mental dhe emocional në situatë pandemie. Kjo ligjëratë po mbahet në shkollat e Lipjanit me nxënësit e krasëve të VI, VII, VIII, IX.

Po zhvillohen aktivitetet për edukim shëndetësor



Kryetari Imri Ahmeti pjesë e fushatës #komunaimeedrejttaimesociale



Embassy of Switzerland in Kosovo

#komunaimeedrejttaimesociale



"Përkundër vështirësive buxhetore, në si Komunë e Lipjanit jemi të përkushtuar në zhvillimin dhe fuqizimin e shërbimeve sociale për qytetarët tonë"

IMRI AHMETI

Kryetar i Komunës së Lipjanit



KOMUNA E LIPJANIT

COVID-19

Komuna e Lipjanit ka mengjuar situaten me pandemi ku deri me daten 30.10.2020 janë identifikuar këto raste:

478
TOTAL

92
AKTIVE

369
TË SHËRUAR

17
TË VDEKUR



KOMUNA E LIPJANIT



MBAJE DISTANCËN



VENDOSE MASKËN



MBAJE HIGJIENEN